



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 3101 prot.

Himarë, më 17.01.2024

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 1 datë, 17.01.2024

**MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE  
NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN SI DHE NGA FONDET E  
BUXHETIT VENDOR**

Në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të nenit 21, të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar me ligjin nr. 9602, datë 28.07.2006, ligjin nr. 10252, datë 11.03.2010, ligjin nr. 25/2013, ligjin nr. 47/2014, ligjin nr. 44/2016, VKM nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", udhëzimit nr. 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%", vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" vendimi nr. 868 datë 29.12.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. Zyra e ndihmës ekonomike i propozon Këshillit Bashkiak të miratojë kriteret e mëposhtme për familjet përfituese nga fondi i kushtëzuar për bllokskemën e ndihmës ekonomike dhe nga fondet e buxhetit vendor.

I. Përfitojnë ndihmë ekonomike:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar më parë në system dhe nuk kanë përfituar për shkak të pikëve të pamjaftueshme dhe janë të varfëra;
2. Jetimët të cilët nuk janë në institucione;
3. Familje me kryefamiljarë femra në vështirësi ekonomike dhe sociale;
4. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune në kushte vartërie ekstreme;
5. Familje me probleme të thella sociale që nuk mundën të realizojnë proceset gjyqësore për zgjidhje martesë dhe vendimet për UMM;

6. Familje ekstremisht të varfëra që kanë në përbërje fëmijë që ndjekin universitetin;
7. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/sëmundje të rënda të cilat nuk përfitojnë nga KMCAJ-ja dhe janë në kushte të vështira socio-ekonomike;
8. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare për 6 muaj pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë të urdhërit të mbrojtjes;
9. Familjet të cilat janë skualifikuar nga sistemi për shkak të mosazhornimit në kohë të tij e provuar me dokumenta si dhe raport social për gjendjen e familjes si familje në nevojë.

Në çdo rast dokumentacioni do të shoqërohet me raport social të përgatitur nga punonjësi social ose sipas rastit njësi e mbrojtjes së fëmijëve, kordinatori kundër dhunës në familje etj.

II. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas VKM nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të gjitha familjet do të trajtohen me ndihmë ekonomike pasi të jetë kryer paraprakisht vlerësimi sociol-ekonomik në familje.

1. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” si dhe udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017 “Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”;
2. Për kushte të veçanta shoqërore ekonomike kërkohen dokumenta shtesë, si vërtetim nga reparti ushtarak, vërtetim nga drejtoria e burgut, nga prokuroria, nga spitali, shkolla, nga zyra e përmbarimit, kur ndonjë anëtar i familjes kryen shërbimin ushtarak, kryen dënimin, ndodhet në gjendje arresti, në spital, në shkollë, ose ka detyrime, urdhër mbrojtje, vërtetim nga gjykata për proces divorci, vërtetim page etj.

III. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, familjet që në përbërjen e tyre kanë goftë edhe një anëtar të familjes, që plotësojnë kushtet sipas përcaktimeve të pikës 9 të VKM nr. 955, datë 07.12.2016.

- a) Kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes dhe jetojnë në të njëjtën strehë nuk trajtohet kurorë e re, me përjashtim të rastit vajzë nënë;
- b) Nuk tërheq ndihmën ekonomike, brënda një afati 10 ditor nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare, për përfituesit e ndihmës ekonomike me përjashtim të rasteve kur ka ndudhur për shkaqe të arësyeshme si shëndetësore dhe fatkeqësi;
- c) Refuzon verifikimin e situatës socialekonomike në familje, refuzimi shoqërohet me procesverbal;
- d) Fsheh informacion ose kryen deklaram të rremë mbi të dhënat e kërkuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të kreut të II, të këtij vendimi;
- e) Nuk deklarohet ndryshimet e situatës socialekonomike në deklaratën e paraqitjes çdo tre muaj të familjes;

- f) Refuzojnë përfshirjen në kushtet e formimit profesional ose refuzojnë ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skëmës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;
- g) Anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, nuk rezultojnë punëkërkues të papunë, apo të vetëpunësuar pranë zyrave të punës.

DREJTOR

Andon Xani



DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharremi



KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

